

Shkolla Sindikale e BSPSH-së është një institucion që ofron shërbime për edukimin e strukturave sindikale dhe anëtarësisë së BSPSH-së. Ajo filloi veprimtarinë e saj në shtator të vitit 2011, me iniciativën e Presidentit të BSPSH-së, zotit Gëzim Kalaja dhe është pjesë e strukturave të BSPSH-së.

Veprimtaria e Shkollës Sindikale të BSPSH-së zhvillohet në bazë të parimit të ligjshmërisë, të përmbushjes me korektësi të detyrës, të zbatimit të rregullave të etikës, të disiplinës në punë, si dhe të bashkëpunimit në kryerjen e detyrave të ngarkuara. Për promovimin e saj u organizua një takim me strukturat drejtuese të BSPSH-së, si edhe të federatave. Mënyrat e bashkëpunimit me strukturat organizative të BSPSH-së parashikohen në një Rregullore të veçantë, si dhe në akte të tjera normative, që nxirren nga Presidenti i BSPSH-së për këtë qëllim.

Shkolla Sindikale e BSPSH-së disponon:

- 2 salla trajnimesh me kapacitet mbi 50 persona, që trajnohen.
- 1 bibliotekë që përmban literaturë ligjore, sindikaliste, ekonomike, studimore si edhe materiale didaktike që shërbejnë për trajnime.

Shkolla Sindikale e BSPSH-së ka organikën e saj ku bëjnë pjesë:

1. **Drejtues i shkollës**
2. **Specialist, lektor për edukimin sindikalist**, si dhe për administrimin e mirëmbajtjen e bibliotekës së shkollës.
3. **Specialist, lektor për edukimin në fushën ekonomike**, nxjerrjen dhe përpunimin e statistikave në shërbim të politikave dhe strategjive të BSPSH-së.
4. **Rrjeti i lektorëve të BSPSH-së**
5. **Rrjeti i lektorëve të federatave**
6. **Rrjeti i lektorëve të rajoneve**